



THE SCHOOL DISTRICT OF PHILADELPHIA

Të Dashur Familje,

Leximi është themeli i të mësuarit gjatë gjithë jetës dhe shkrim-leximi mund të hapë dyert që i ndihmojnë studentët tanë të përparojnë.

Për të promovuar shkrim-leximin dhe për të ndihmuar nxënësit të zgjerojnë aftësitë e shkrim-leximit, Drejtorja Arsimore e Filadelfias ka kënaqësinë të shpallë "20 in 20 Reading Initiative" "Nëpërmjet kësaj nisme të re, ne po inkurajojmë nxënësit e klasës së tretë të lexojnë 20 libra në 20 javë deri më 24 Prill 2023.

Çdo nxënës do të marrë 10 libra me interes të lartë, me rëndësi kulturore për të ndërtuar bibliotekat personale të studentëve në shtëpi, për të rritur gëzimin e studentëve në lexim, kultivojnë aftësitë e tyre të shkrim-leximit dhe zgjerojnë reflektimet e tyre për veten dhe botën përreth tyre. Nxënësit inkurajohen të ndjekin përparimin e tyre deri më 24 Prill 2023. Ata që përfundojnë me sukses këtë nismë do të marrin një nxitje për të gjithë punën e tyre të palodhur.

Ne ju inkurajojmë të merrni pjesë në këtë iniciativë dhe të ndihmoni në zhvillimin e aftësive të leximit, të kuptuarit dhe shkrim-leximit të fëmijës suaj.

Këtu janë disa këshilla për ju për të përmirësuar këto përvoja në shtëpi:

Të lexuarit së bashku:

- Kur lexoni së bashku, ju dhe fëmija juaj lexoni me radhë pjesë të një libri. Kur lexoni, kërkoni nga fëmija juaj të krijojë lidhje me tregimin duke bërë pyetje si:
 - Pse zgjodhët këtë libër?
 - Si ju ndihmojnë titujt për të gjetur informacionin?
 - Si e dini se çfarë po thoni për librin është e saktë?
 - Si e paraqet autori informacionin?

Para - Gjatë - Pas Leximit

- Bëni pyetje para, gjatë dhe pas leximit me zë të lartë. Kjo mund ta ndihmojë fëmijën tuaj të përqendrojë vëmendjen në idetë në tregim. Para se të lexoni, shikoni kopertinën e librit dhe flisni për atë që mund të ndodhë në tregim. Gjatë leximit, pyesni se çfarë pyetjesh ka ai/a jo në lidhje me tregimin. Pasi të lexoni, flisni për atë që ndodhi. Kërkojini fëmijës tuaj ta përmbledhë atë dhe ta ndërlidhë historinë me atë që ai/a jo tashmë di ose ka përjetuar.

Për nxënësit të cilët gjuhën angleze e kanë gjuhë të dytë:

- Nëse përdorni një gjuhë tjetër në shtëpi, flisni dhe lexoni me fëmijën tuaj në atë gjuhë. Kjo mund të ndihmojë në rritjen e fjalorit dhe të krijojë lidhje në shkollë. Mund të rrisë

gjithashtu kuriozitetin dhe gatishmërinë për të mësuar në shkollë. Mundësitë e të mësuarit në një gjuhë amtare do të ndihmojnë në mësimin e shkrim-leximit në Anglisht.

Përveç këtyre këshillave, këtu janë mundësitë dhe programet shtesë të leximit:

- **Komuniteti i leximit dixhital:** Familjet marrin kërkesa për të rritur diskutimin e librave, lojëra të lidhura me libra, vizita virtuale të autorëve, një bibliotekë dixhitale me më shumë libra për të lexuar dhe aktivitete të tjera në <http://scholastic.com/phillyreadandgrow>
- **Pyetje:** Shkoni te AskTerica@scholastic.org
- **Power Library:** është portali online për të gjitha ato që ofrojnë bibliotekat e Pensilvanisë. Ky është vendi për të gjetur akses 24/7 në gazeta, revista, dokumente dhe foto historike, baza të të dhënave në internet dhe libra elektronikë. Studioni një temë. Mësoni për historinë tuaj familjare. Gjeni një titull. Eksploroni opsionet e karrierës. Është e gjitha këtu në POWER Library.
Llink/ Lidhja:
<https://sites.google.com/philasd.org/sdppowerlibrary/home>

Për të mbështetur këtë iniciativë, ne do të ndajmë lexime me zë të lartë përmes faqes sonë të internetit dhe mediave sociale. Ju inkurajojmë gjithashtu të ndani fotot tuaja me ne! Ju lutemi, na dërgoni fotografitë e fëmijëve tuaj me libra dhe/ose duke lexuar në adresën academicprojects@philasd.org. Këto fotografi mund të përdoren në platformat e mediave sociale të Drejtorise.

Faleminderit për mbështetjen tuaj dhe për pjesëmarrjen në përvojat e leximit të fëmijës suaj në shtëpi. Mbështetja e kësaj nisme mund të zhvillojë aftësinë e leximit, aftësitë gjuhësore të fëmijës suaj dhe të rrënjosë dashurinë për të lexuar.

Nëse keni ndonjë pyetje, ju lutemi kontaktoni academicprojects@philasd.org.

Sinqerisht,

Zyra e Mbështetjes Akademike